



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.1010/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Inspektionit, adresa rruga “UÇK”, Prishtinë, kundër debitorit “Beki Partners” SH.P.K., me NUI:811336404, me seli në Prishtinë, rruga “Kolë Parubi” p.n., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit përmbartimor P.nr.243/23 të datës 25.05.2023, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 26.09.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Beki Partners” SH.P.K., ANULOHET Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.243/23 i datës 25.05.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.243/23 të datës 25.05.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Urdhresës për Ndëshkim me Gjobë Mandatore për Kundërvajtje me numër 002254 të datës 30.04.2023, me të cilën është urdhëruar debitori që t’ia paguaj kreditorit në emër të gjobës shumë prej 100.00 € si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave ligjore, në të kundërtën përmbartimi të realizohet përmes bllokimit të të gjitha llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e të hollave në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimin, vlerësimin, me shënimin e përmbartimit në librin publik të paluajtshmërive, dërgimin, të besuarit për ruajtje, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e kreditorit nga shuma e fituar me shitjen, përmbartimi për pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë

tregtare dhe me qëllim të dorëzimit të sendeve të luajshme si dhe të i ndalohet debitorit dhe personave të tjera dhe organeve që marrin pjesë në zbatimin e përmbarimit, çfarëdo disponimi dhe fshehje e pasurisë së debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se kundërvajtja për të cilën i është shqiptuar gjoba i vihet në barrë personit juridik pra debitorit “Beki Partners” dhe jo punëtorit të tij Naser Fazliut si person përgjegjës në kompani. Ka theksuar se, me gjobën e shqiptuar është shkelur neni 24 par.1 i Ligjit për Kundërvajtje dhe gjoba i është shqiptuar subjektit të gabuar. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj prapësimin e debitorit dhe të anuloj Urdhrin Përmbarimor dhe të gjitha veprimet e tjera procedurale të ndërmarra në këtë procedurë.

Kreditori në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit duke deklaruar se dokumenti përmbarues i nxjerrë në procedurë administrative është i përmbarueshëm sipas rregullave të Ligjit për Kundërvajtje. Tutje ka shtuar se, referimi lëndës tek përmbaruesi privat është bërë në përputhje të plotë me Ligjin për Procedurën Përmbarimore. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj prapësimin e debitorit, të vërtetoj Urdhrin Përmbarimor P.nr.243/23 të datës 25.05.2023 dhe të obligoj debitorin që të përmbush obligimin sipas propozimit për përmbarim së bashku me shpenzimet e procedurës përmbarimore deri në përfundim të çështjes.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se dokumenti mbi të cilin është propozuar lejimi i përmbarimit, Urdhëresa për Ndëshkim me Gjobë Mandatore për Kundërvajtje me numër 002254 e datës 30.04.2023, nuk përbën bazën juridike për caktimin e përmbarimit pasi që nuk paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 21 i cili përcakton “*Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në*

*bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”.*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti Urdhëresa për Ndëshkim me Gjobë Mandatore për Kundërvajtje me numër 002254 e datës 30.04.2023, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk përmban atributet e një vendimi të organit administrativ, i cili mund të këtë cilësinë e dokumentit përmbarues sipas nenit 23 par. 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse akt pajtim administrative konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër.”*

Gjykata vlerëson se ky akt i kreditorit Urdhëresa për Ndëshkim me Gjobë Mandatore për Kundërvajtje me numër 002254 e datës 30.04.2023, trajtuar në cilësi të dokumentit përmbarimor, nuk është nxjerrë në harmoni me dispozitat e nenit 45, 46, 47, dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative 05/L-031, sepse i mungon forma e aktit administrativ, struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ.

Gjykata vlerësoi urdhrin për përmbarim duke u bazuar në nenin 43 paragrafi 4 të LPP-së me të cilin përcaktohet se: *“Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim.”* dhe gjeti se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim, për shkak se dokumentit mbi bazën e të cilit është iniciuar procedura e përmbarimit i mungon përshtatshmëria për ekzekutim.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1010/23, datë 26.09.2023

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.